

Patterns of distortions of aesthetic values over the Communist era

Abstract: *The paper examines the distortions of literary aesthetic value during the communist period in Albania, analysing the ideological interventions of the totalitarian state on literary history, the canon, and translations, whose consequences are still evident in the educational system. Among the key events stands out the Third Conference of the Writers' League (1949), which institutionalized socialist realism as both a creative method and literary critique, overturning previous achievements and establishing a strict demarcation between "progressive" and "reactionary" literature. The analysis highlights the deformations of literary historiography of this period, especially in the History of Albanian Literature (1983), where authors such as Gj. Fishta, F. Konica, and E. Koliqi were excluded or stigmatized, while other authors such as De Rada, Z. Serembe, N. Mjeda, M. Kuteli, Migjeni, and L. Poradeci etc., were misinterpreted according to ideological schemes. Likewise, translations from world literature were reduced to a narrow repertoire, politically controlled, serving as a tool of indoctrination rather than an aesthetic and cultural resource. The study argues that such a process led to the loss of creative subjectivity and critical objectivity, turning literature into a mouthpiece of propaganda.*

In conclusion, the paper emphasizes the need to correct the inherited distortions in literary historiography and the Albanian educational system, in order to restore the aesthetic dimension of Albanian literature as part of the broader movement of European literature – this being the only way through which Albanian literature can be displayed in its entirety.

Keywords: *Socialist Realism, Deformed Literary Canon, Censorship and Ideology, History of Albanian Literature, Albanian Educational System.*

Është fakt i njohur se në periudha totalitare, artet karakterizohen nga devijimi i funksionit estetik në atë utilitar, qëllimor, propagandistik e didaktik, ndaj shteti u kushton vëmendje të veçantë shkrimtarëve dhe artistëve për t'i mbajtur e mbikëqyrur në hullinë ideologjike.¹ Në këtë

1 Po shënojmë këtu përfaqësues, si: filozofin Herbert Marcuse, *The Aesthetic Dimension*

përplasje të fortë mes shpirtit të lirë, që karakterizon çdo vepër artistike, si dhe funksionit estetik të letërsisë, nga njëra anë dhe ngurtësimit të procesit krijues në kallëpe soc-realistë e ideologjikë, (aspekt që solli censurimin, anatemin madje edhe asgjësimin fizik të autorëve shqiptarë të periudhës totalitare në Shqipëri), nga ana tjetër,- gjenden shformimet dhe përmbysjet në rrjedhën e zhvillimeve të letërsisë shqipe.

Sistemi totalitar ndërhynte dhunshëm në struktura thelbësore për artin, ndërhyrje mes të cilave veçojmë: *Historitë e letërsisë shqipe*, vepra të ndërtimit të kanonit letrar dhe trajtimin e letërsisë në *shkolla* e në sistemin arsimor të të gjitha niveleve. Përveç këtyre dy institucioneve tejet të rëndësishme, shteti kishte shtëpitë botuese dhe përmes tyre kontrollonte imtësisht krijimtarinë e çdo poeti ose shkrimtari, si dhe përkthimet nga letërsia botërore, që duhej të vinin në shqip në përputhje të plotë me platformën e realizmit socialist dhe ideologjinë marksiste, *për të mbrojtur kështu popullin nga çdo shfaqje e letërsisë "reaksionare"*-siç cilësohej vazhdimisht letërsia e vendeve perëndimore- ose nga vepra të dekadentëve të huaj, në krijimet artistike të të cilëve, në vend të entuziazmit revolucionar kolektiv dhe ngjyrave të ndritshme, zotëronte trishtimi, ambiguitetet dhe vetmia.

Kjo qasje disakëndore na mundëson të analizojmë modele me peshë specifike të devijimit dhe të përmbysjes së funksionit estetik letrar, devijim që, më tej, nga veprat artistike përfigurohet në shformimin e mozaikut të historisë së letërsisë shqipe, gjurmë të së cilës i hasim edhe sot. Prej këtej do të propozojmë rrugë të mëtejshme për integrimin sa më të plotë estetik të rrjedhave letrare në historiografinë e letrave shqipe dhe sistemin arsimor.

Do të përqendrohemi më poshtë në raportet e shtetit totalitar me letërsinë duke trajtuar në nivel të modelit pasojat e goditjeve, imponimeve dhe dhunimeve të letërsisë shqipe në disa rrafsh.

(1978), i cili argumenton se arti në sisteme totalitare e humbet autonominë estetike dhe reduktohet në funksion utilitar e ideologjik; teoricienët e letërsisë René Wellek dhe Austin Warren, autorët e *Theory of Literature* (1949) që merren me marrëdhëniet e letërsisë me ideologjinë, duke kundërshtuar thjeshtimin e kritikës letrare në ideologji dhe duke këmbëngulur në funksioni estetik veprës. Terry Eagleton në *Literary Theory: An Introduction* (1983), argumenton se çdo teori letrare (formalizmi, strukturalizmi, post-strukturalizmi etj.) bart pozicione ideologjike mbi kulturën dhe shoqërinë, ndërsa në *The Ideology of the Aesthetic* (1990), shtjellon se si estetika shpesh instrumentalizohet nga pushteti për qëllime ideologjike dhe didaktike. Model përfaqësues përbën edhe George Orwell i cili në romanin *1984* (1949) dhe në esenë *Politics and the English Language* (1946), shpjegon manipulimin e gjuhës dhe artit si mjete propagande në regjimet totalitare.

Historia e letërsisë shqipe - kanoni i gjymtuar i letrave të bukura

Historia e letërsisë shqipe është institucion i pazëvendësueshëm i pasurisë sonë letrare, institucion në panteonin e të cilit kanë vend autorë kanonikë me vlerë estetike të dallueshme që brendashkruajnë jetën letrare të kombit në trashëgiminë shpirtërore të tij dhe njëherësh mes përvojave artistike të vendeve europiane e më gjerë.

Ndërkohë, historia e letërsisë shqipe është vatër rrezatimi për tekste universitare dhe shkollore në linjë vertikale, prej nga buron informacioni shkencor për formimin e nxënësve dhe studenteve, një pjesë e të cilëve do të ushtrojnë profesionin e mësuesit dhe do të përçojnë dije mbi autorë, vepra e dukuri të letrave shqipe. Kjo vatër rrezatimi krijon një qark të mbyllur të segmenteve të ndërvarrura njëri nga tjetri, në kuptimin që, nëse goditet njeri segment i tij, efektet e natyrës shkak-pasojë kapin krejt segmentet e tjera.

Historia e letërsisë është teksti fundamental për studiuesit dhe kritikët e letërsisë e të artit në boshtet e të cilës mbështeten studime monografike, analitike e interpretative mbi autorë e shkolla letrare.

Ideja tashmë referenciale e një “sterne të madhe simbolesh, imazhesh, dhe përvojash”², që vjen nga historiani i letërsisë italiane Romano Luperini e që lidhet me ridimensionimin sistematik të të dhënave bashkëkohore, që u krijojnë mundësi të rinjve t’i japin kuptim jetës përmes veprave artistike, na thekson sërish rëndësinë që kulturat e kombeve të mëdha u japin letërsive nacionale në politikat arsimore, në kurrikulat shkollore e universitare e në procesin e mësimdhënies, për shkak të lidhjes sa të brendshme aq dhe të drejtpërdrejtë që letërsia ka me formimin dhe edukimin e gjeneratave.

Viti 1925 shënon tekstin e parë të historishkrimit të letërsisë shqipe, nën titullin *Letratyra Shqype për shkolla të mjesme*, nga At Justin Rrota, botuar në Shkodër më 1925, - përpjekja e parë në fushë të historiografisë mbi parime gjithëpërfshirëse, që vë theksin në përbërës stilistikë e gjuhësore të ndërtimit artistik të veprave letrare. Detyrën e Historisë së letërsisë, At J. Rrota e lidhte me detyrën e çdo shoqërie të qytetëruar për të ruajtur ekzistencën e vet, për të ruajtur monumentet letrare. Këtu, ai shënon se “mund të shpresohet se këjo letratyrë pershpejti do të perparojë mjaft e lulzueshme, sa në pakë kohë ka me shkue krahas me letratyrë të rë të komevet tjera të Ballkanit.”³

Në vitin 1941, nën kujdesin e E. Koliqit u botua në dy volume *Shkrimtarë Shqiptarë, Histori e Letërsisë Shqipe* -tekst i përgatitur nga N. Resuli e K. Gurakuqi, që përbën botimin më të suksesshëm e të plotë të historishkrimit të letërsisë sonë. Vepra synonte sistematizimin e letërsisë nga fillimet deri

2 Shih për më shumë kreun e parë, në: Romano Luperini, *Insegnare la letteratura oggi*, Manni, 2020.

3 At Justin Rrota: *Letratyra Shqype për shkolla të mjesme*, Shkodër, Shtypshkoja Françiskane, 1925, f. 102.

në vitet '40, duke kombinuar të dhënat biografike me interpretimin artistik e formal të veprave, si dhe debate e gjykime kritike alternative për çështje të veçanta. Çështja e *errësisë* së veprës së De Radës për shembull, interpretohet kështu: “De Rada është i errët jo vetëm e vetëm prej “kujdesimeve gjuhësore” që ka pasur, por se kërkon më tepër vetë të jetë i errët, a qatë thomi me një shprehje italisht është “volutamente oscuro”.⁴

Në vështrim të gjerë kulturor, duhet të theksojmë se vitet '30-'40 të shekullit të kaluar kanë shënuar maja letrare e, më në përgjithësi, kulme kulturore, sa edhe arritje në fushë të mendimit intelektual shqiptar dhe dy veprat e lartpërmendura dëshmojnë pikërisht: analizë figurative e artistike të letërsisë, karakteristika të shkollave letrare dhe qasje përbashkuese me letërsitë europiane. Duke u konceptuar e realizuar të tilla, ato dallohen si vepra që e trajtojnë aktin krijues si çlirim shpirtëror, subjektiv dhe krejt personal.

Me përfundimin e Luftës II Botërore dhe krijimin e qeverisë së re, janë të kuptueshme motivet përse shteti diktatorial i periudhës 1945-1990, i kushtoi kujdes të veçantë hartimit të një tjetër kanoni letrar dhe pse do ta drejtonte me dorë të hekurt edukimin artistik të masave, ndaj, në këtë plan, Dh. Shuteriqi e Sh. Musaraj etj. botuan në revista ndër vitet 1946 - '49 (si te *Bota e re*, *Literatura jonë* dhe në organe të përditshme, si *Zëri i popullit*, *Bashkimi* etj.) për të përgatitur truallin e Konferencës III të Lidhjes së Shkrimtarëve, në vitin 1949. Kjo ngjarje vendosi përfundimisht letërsinë nën drejtimin e plotë të Partisë, duke caktuar vijën e demarkacionit mes letërsisë përparimtare e reaksionare, duke imponuar metodën krijuese e të kritikës letrare, si dhe duke shpallur armiq të partisë e të shtetit poetë e shkrimtarë që kishin parime të ndryshme estetike.

Ndër shkrimet, artikujt dhe recensionet që i përgatitën truallin Konferencës III të Lidhjes së Shkrimtarëve shënojmë recensionin e Dh. Shuteriqit botuar në revistën *Literatura Jonë*, *Si u kalit çeliku*, mbi veprën e N. Ostrovskit, të cilin letërsia sovjetike e mbante si një ndër sukseset e realizmit socialist, “një nga ato mësimet që i ep botës Bashkimi Sovjetik,”⁵ si dhe artikullin me titull *Rreth prodhimit letrar e artistik të vitit 1947*, që trajtonte “romantizmin” dhe “sentimentalizmin” si rrjedhoja të “influcencës së madhe të natyrës”⁶ apo të dëshirës për t’u dhënë më shumë *pas bredhave* se sa pas njeriut dhe kërkesave të kohës.

Në prag të fillimit të punimeve të Konferencës III të Lidhjes, Enver Hoxha porosiste: “Të mos merremi me diskutime boshe për autorë reaksionarë si

4 E. Koliqi, N. Resuli, K. Gurakuqi: *Shkrimtarë Shqiptarë, Histori e Letërsisë Shqipe*, Tiranë, 2007, f. 264.

5 *Literatura Jonë*, Tiranë, 1947/1, f. 6.

6 *Literatura Jonë*, Tiranë, 1948/2, f. 2.

Fishta, Koliqi etj. ...”⁷

Teksa merret me përhapjen e realizmit socialist në Shqipëri, studiuesi Ali Xhiku thekson se realizmi socialist nuk kishte nevojë për shumë teori, pasi marksizëm-leninizmi sqaronte edhe çështjet e letërsisë. Prandaj, “mjaftonte që vizionet e tij ashtu siç i kuptuan komunistët që morën përsipër t’i vënë në jetë, të konkretizoheshin me orientime, udhëzime, e vendime të posaçme. Të gjitha këto erdhën e u shtuan veçanërisht pas kongresit I të Partisë Komuniste (1948), kur realizmi socialist u konsakrua si rruga e vetme që do të ndiqte këtej e tutje jeta artistike e vendit”⁸.

Pas mbarimit të konferencës e në vijim deri në rënien e regjimit komunist, do të flitej vetëm për dy tipologji shkrimesh, gjegjësisht kulturash, ajo përparimtare me rrënjë tek populli, që duhej ruajtur e zhvilluar, ose poli i kundërt i saj, kultura reaksionare, shprehëse e psikologjisë së klasave sunduese, që duhej hedhur tej.

Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve përmbysi gjithë arritjet e deriasokohetë letërsisë dhe artit dhe u diktoi krijuesve dhe studiuesve kallëpin socrealist për një art të ri popullor e qëllimor që i përgjigjej ndërtimit të njeriut të ri revolucionar e besnik të partisë. Propaganda, ideologjia komuniste që buronin nga ish Bashkimi Sovjetik dhe ish Jugosllavia shërbyen si burim e model për artistët tanë. Konferenca e 1949-ës imponoi një praktikë ekstraletare, të partishme e ideologjike, ku letërsia shihej si zëdhënëse e propagandës qeveritare dhe duhej të pasqyronte shtetin socialist, rezultatet në fabrika e prodhimtari, gëzimin e njeriut nën diktaturën e proletariatit, thënë ndryshe, të bëhej zëdhënëse e propagandës shtetërore si kur shpreheshin për mbeturina të dekadentizmit, për frymë simboliste, impresioniste, surrealiste, futuriste etj. ashtu dhe për mësim, ide kryesore e qëllime që duheshin nxjerrë për brumosjen e njeriut të ri. Si rezultat i kësaj politike centralizuese, që u praktikua shumë më egërsisht se sa në vendet nga buronte, filloi të themelohej një sistem letrar i cungët e mjaft problematik, madje duke censuruar, anatemuar e përndjekur fizikisht shumë përfaqësues të vlerë të letërsisë shqipe, duke censuruar pjesërisht të tjerë autorë, si dhe duke dhunuar e deformuar parimet kritike e studimore të saj.

Pasi kritikon Sefulla Malëshovën që nuk është dakord me vijën e demarkacionit midis Fishtës dhe Mjedës duke argumentuar sipas ideologjisë së partisë se Mjeda ka këngë si *Lirija*, ndërsa Fishta bën pjesë te krerët reaksionarë të klerit katolik në vend, Sh. Musaraj shkruante: “Po Sejfullahu thotë se nuk munt ta ndajmë Mjedën nga Fishta pa bërë një analizë të hollë se ç’klase dhe ç’botëkuptimi filozofik i përkisnin këta

7 Enver Hoxha, *Për letërsinë dhe artin*, Tiranë, 1977, f. 30.

8 Ali Xhiku, *Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945-1961*, Tiranë, Akademia e Shkencave, 2022, f. 106.

njerëz ... Jo. Ne s'mendojmë kështu, në s'duam të lëmë punën që kemi përpara për të humbur në labirintin e kritikës së letërsisë së kaluar... do të gërmojmë edhe arshivat e vjetra, si kemi filluar të bëjmë në realitet, dhe do të nxjerrim prej tyre, më parë gjërat që pëllasin, që s'duan shumë kallauzë dhe do t'i futim në punën tonë. Këtë na mëson edhe eksperiencia e çmuarshme sovjetike.”⁹

Në përputhje të plotë me direktivat e partisë, të mbështetur në përvojën e letërsisë sovjetike për të praktikuar metodën e realizmit socialist, si dhe në mbështetje tërësore të hovit revolucionar të masave në luftën për ndërtimin e socializmit dhe ashpërsimit të luftës së klasave në fushën e letërsisë Lidhja e shkrimtarëve angazhohej për “luftë të ashpër kundër mbeturinave ideologjike të shoqërisë borgjeze-kapitaliste në fushë të letrave (shovinizmit, apolitizmit, artit për art, dekadentizmit), që përbëjnë rrezikun më të madh në rrugën e zhvillimit të letërsisë sonë të re”.¹⁰

Për A. Xhikun, komunistët e mendonin veten si revolucionarë të përherëshëm dhe për ta ishte më se e natyrshme të kërkonin prej letërsisë ta krijonte të bukurën vetëm te pasioni revolucionar që karakterizonte njeriun e ri të shoqërisë socialiste e komuniste. “Kur kërkonin nga shkrimtarët ta shihnin të bukurën te jeta e punëtorit dhe e fshatarit, te puna e tyre heroike dhe e hareshme njëkohësisht, te ndërtimi socialist në përgjithësi, pra tek ua drejtonin tematikën, ata nuk donin që të vinin re se po u binin ndesh letërsisë si vetëqenie.”¹¹

Produkt i shtetit diktatorial, i dhunës e totalitarizmit në të gjitha fushat e më konkretisht pasojë e konferencës III të 1949-ës është vepra *Historia*

9 *Konferenca e III-të e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (9-12 tetor 1949)*, Tiranë, 1950, f. 86. Më poshtë vijon: “Po kjo çështje, ashtu si e shtron Sefullau, nuk ka vetëm kuptimin që të lëmë punën e sotme dhe të humbasim në labirintin e letërsisë së kaluar. Ka edhe një kuptim tjetër: Të ngatërrojmë Mjedën me Fishtë, të mos guxojmë të themi qysh sot se Fishta është i armikut dhe Mjeda është yni, ose për më kollajllëk, pasi janë të dy klerikë, ta hedhin dhe Mjedën m’atë anë. Këtë kërkon të bëjë dhe armiku. Po ne këtë nuk e bëjmë.” (f. 86).

10 Po aty, f. 36.

Në fjalën përshëndetëse, shoku Bedri Spahiu shprehte qartë se Komiteti Central i Partisë “konsideron se nga parimi i math se letërsia duhet të jetë letërsi e Partisë, d.m.th. që çështja e saj të bëhet pjesë e pandarë e kauzës së masave punonjëse, përcaktohen baza mbi të cilat do të zhvillohet më tej letërsia. Me kuptimin e drejtë dhe të plotë të këtij parimi, lehtësohet zgjidhja e problemeve të letërsisë si metodika, tematika, përmbajtja dhe forma, gjuha, lloji i prodhimit etj. Lufta në frontin e letërsisë në fund të fundit, zhvillohet rreth këtij strumbullari dhe armiku në format më të ndryshme të luftës në këtë front, ka si objektiv pikërisht këtë parim që konsakron çështjen e letërsisë si pjesë të pandarë të kauzës së përbashkët të masave punonjëse. (...) Ju e dini se nuk munt të bëhet asnjë as një përzierje në mes të veprave të Naimit, Çajupit, Migjenit, shkrimtarëve të luftës N. Ç. dhe të çlirimit dhe atyre të Fishtës, Konicës, Kutelit, Koliqit, etj.” (Po aty, f. 7).

11 Po aty, f. 113-114.

e *Letërsisë Shqipe I, II*, hartuar pranë Institutit të Shkencave nga një grup autorësh nën redaksinë e Dh. Shuteriqit, K. Bihikut e M. Domit, botuar në Tiranë 1959, 1960 - tekst akademik e universitar i hartuar në përputhje të plotë me parimet politike e ideologjike të shtetit diktatorial. Teksti i 1959-'60 përbën përpjekjen e parë për hartimin e një teksti akademik e universitar e njëherësh "suksesin" për kanonizimin e historisë së letërsisë pas parimesh partiake. Parimi i krijimit të kanonit të autorëve shqiptarë është: historia e letërsisë nuk ka për detyrë të jetë gjithëpërfshirëse, ajo ndërton kanonin e saj dhe për të tjerë autorë hesht. (si për Gj. Fishtën, F. Konicën, E. Koliqin, M. Camajn etj.).

Për shkrimtarët e poetët diktohet shtegu i leximit, kështu, për shembull, tek Serembe theksohet se "sëmundja, dashuria e pafat, e bënë Seremben të bjerë në melankoli, dëshpërim, ndonjëherë në pesimizëm a në misticizëm fetar, dhe t'i japin karakter negativ një pjese të poezisë së tij."¹²

Për fat të keq ky poet shumë i veçantë i letërsisë sonë njihet ende sot me poezitë patriotike që nuk përbëjnë majat estetike të tij, përkundrazi, ndërkohë që vula e karakterit negativ të poezisë që i vendosën kritikët besnikë të partisë, akoma nuk i është shqitur.

Në vijim të këtij punimi u desh të hulumtonim edhe një tjetër tekst për realizmin socialist nën titullin *Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist*, (maket) botuar në Tiranë, 1978. Teksti u hartua nga një grup autorësh nën drejtimin kryeredaktorial të K. Bihikut, ai u ribotua disa herë në vitet 1979, 1983, 1986 dhe qarkulloi për studentët në formë dispense në dy vëllime. Objektivi kryesor i tekstit në fjalë qëndronte në përvijimin e rrugëtimit të letërsisë shqipe të realizmit socialist prej fillesave dhe në fazat e zhvillimit të tij, duke e shqyrtuar në lidhje të ngushtë me "luftën për ndërtimin e shoqërisë socialiste, si edhe përpjekjet e shkrimtarëve të sotëm për zgjidhjen e detyrave që u ka vënë përpara shoqëria në etapat e ndryshme të zhvillimit të saj historik. Në vepër ndriçohet roli udhëheqës i Partisë në zhvillimin dhe në pasurimin e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, lufta që ka zhvilluar ajo për një art në shërbim të masave punonjëse, për një art militant, të frymëzuar nga idealet e socializmit dhe të komunizmit."¹³

Metoda e studimit, partishmëria, heroi pozitiv, letërsia qëllimore si zëdhënëse e ideologjisë, çështja e traditës dhe e novatorizmit, ajo e pasurimit të realizmit socialist krahas zhvillimit të shoqërisë dhe pika të tjera të realizmit socialist gjenden "në dokumentet e Partisë, ku janë zgjidhur një varg çështjesh me rëndësi të madhe teorike të procesit historiko-letrar si: çështja e zhvillimit të letërsisë sonë në rrugën e realizmit socialist si metodë krijuese dhe drejtim letrar, që u përgjigjen kërkesave ideologjike të

12 *Historia e Letërsisë Shqipe I, II*, Tiranë 1959, 1960, f. 194.

13 *Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist*, (maket) botuar në Tiranë, 1978, f. 3.

shoqërisë shqiptare pas çlirimit ... çështja e luftës së papajftueshme kundër shfaqjeve të ndryshme konservatore dhe borgjezo-revizioniste në brendi dhe në formë si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mbarë të letërsisë dhe të arteve të realizmit socialist.”¹⁴

Historia e letërsisë e '59-ës, siç njihet, qarkullonte në të gjitha nivelet, dhe u bë tekst bazë mbi të cilin u hartua *Historia e Letërsisë Shqiptare*, botuar në Tiranë më 1983, një punë në grup, drejtuar nga Dh. Shuteriqi. Ky tekst përfaqëson historishkrimin zyrtar të letërsisë sonë, presionin e politikës e të shtetit totalitar mbi letërsinë, duke i rrënjosur deformimet e skajshme në përzgjedhjen e veprave, autorëve, si dhe duke analizuar dhe interpretuar sipas metodave ekstraletrare, ideologjike, krijimtarinë letrare në dëm të vlerës estetike.

Teksti i '83-it dëmtoi rëndë sistemin e letrave shqipe nga mospërfshirja e përfaqësuesve të saj më të rëndësishëm tek diskriminimi i tyre si dhe, për fat të keq, e unifikoi shijen letrare të lexuesve bazuar në parimet e njohura të realizmit socialist.

Në këtë tekst, historia e letërsisë konceptohet si zhvillim që ecën dhe evoluon shkallë-shkallë sipas kushteve historiko-politike e social kulturore të popullit, ku ideologjia e shtetit artikullohet e aplikohet si parim historishkrimi. Autorët e përfshirë janë lexuar dhe interpretuar ideologjikisht (kapitulli II, III), prandaj, trajtimi i tyre është rezultat paraprak i skemës së leximit dhe i vlerësimit kritik. Janë rrafshuar tipare artistike, janë lënë jashtë vepra dhe autorë¹⁵, janë prekur vetëm sa për t'u stigmatizuar emra të rëndësishëm të letërsisë shqipe, si Gj. Fishta,¹⁶

14 Po aty, f. 10.

15 “Mjaft t'i hidhet një sy variantit të dytë të statutit të Lidhjes së Shkrimtarëve, që u miratua në Konferencën e saj të Tretë (tetor 1949) për të arritur në përfundimin se komunistët jo vetëm që nuk do të lejonin të hynin në atë organizatë shkrimtarë “të cilët i kishin shërbyer me veprat e tyre okupatorit [...]”, që ishin “bërë armiq të popullit”, por do të përjashtonin këtej e tutje edhe ata anëtarë, “veprimtaria e të cilëve” do të binte “në kundërshtim me interesat e ndërtimit të bazave të socializmit dhe me detyrat e tjera të Lidhjes” Kjo organizatë, që u krijua dhe u konsolidua brenda 3-4 vjetësh, iu nënshtrua së njëjtës syçeltësi me të cilën komunistët kontrollonin të gjitha zhvillimet e jetës shqiptare. Sipas tyre, nuk kishte asnjë arsye që mbikëqyrja ideologjike mbi Lidhjen të ishte shqetësuese për anëtarët e saj.” Ali Xhiku, f. 20 -21.

16 Për Gjergj Fishtën, autorët e tekstit shprehen se *Lahuta e Malcis* (...) “i ngrinte himnin patriarkalizmit e bajraktarizmit, obskurantizmit fetar e klerikalizmit, dhe spekulonte me ndjenjat patriotike kur ishte fjala për të ngritur lart ngjarje e figura të historisë kombëtare të periudhës së Rilindjes sonë. Vepra të tjera si poema satirike, “Gomari i Babatasit”, ku u sulmuan me tërbim laicismi i shkollës dhe idetë patriotike, ishin karakteristike të luftës së egër që bëri kleri katolik për të ruajtur e për të rritur ndikimin e tij në jetën mendore të vendit. Këtij arti përpiquej t'i shërbente një formë që i qëndronte pranë folklorit. Atë e shoqëronin shesh prolksiteti, efektet e kërkua, retorizmi, brutaliteti i shprehjes e i stilit, gjer në banalitet, argumentimet e tyre false, që orvaten të imponohen me pahir, si dhe një qëndrim i theksuar konservator në

F. Konica¹⁷ e, të trajtuar në tekste të mëparshme, ndërsa janë trajtuar njëanshëm dhe keqinterpretuar poetë e prozatorë si: De Rada, Z. Serembe, N. Mjeda, M. Kuteli, Migjeni, L. Poradeci¹⁸ etj. Gjurmë të keqinterpretimeve të tilla ndeshen edhe sot, veçanërisht, në arsimin parauniversitar. Këto keqinterpretime derivojnë sidomos nga përcaktimi i drejtimit *reaksionar klerikal e borgjez*, në mënyrë të veçantë kur është fjala për letërsinë moderne të periudhës 1912-1939:

“Në këto vite dalin më qartë dy drejtimit e kundërta, që i hasëm në letërsinë e Rilindjes: drejtimi demokratik, i cili shpie më tej trashëgimin e lëvizjes për çlirimin kombëtar dhe u përgjigjet aspiratave të masave për një rend të përparuar politik, ekonomik e shoqëror; drejtimi reaksionar klerikal e borgjez, i cili karakterizohet nga idealizimi i mbeturinave patriarkale-fisnore, rreh të ruajë regjimin antikombëtar e antipopullor të feudoborgjezisë dhe i hap rrugën pushtimit imperialist e fashist.”¹⁹

Madje, parimet krijuese të De Radës, të përcaktuara si “volutamente oscuro” (sipas tekstit *Shkrimtarë Shqiptarë*, 1941), përmbysen në këtë tekst, për t’u shndërruar në *paqartësi* të veprës që dëmton kuptimin, që dëmton idetë e poemës dhe strukturën e saj - strukturë që do të konsiderohej këtej e tutje si *fragmentare*.

Pra, *Historia e Letërsisë Shqiptare* e 1983-it, teksti që ka hedhur rrënjë në formimin e arsimitarëve dhe të studiuesve, bën që errësinë dhe ligjërimin sintetik të *Këngë të Milosaos*²⁰ të De Radës, kryeveprës së romantizmit tonë- ta shohin si dobësi artistike të poemës në përputhje me linjën e demarkacionit të konferencës e ’49-ës dhe jo si veçori estetike e përzgjedhje poetike të vetëdijshme strukturore, që e përbashkon kryepoetin tonë

lëmin e gjuhës. Fishta i mbaroi ditët si akademik i Italisë fashiste.” *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1983, f. 470-471.

17 Shpesh ai e paraqiti në mënyrë të tillë të errët pamjen e vendit, sa ushqeu mosbesimin në një të ardhme të përparuar e përgjithësisht në forcat popullore e përparimtare, duke mbrojtur, nga ana tjetër, që në krye të herës, tezën se vetëm paria aristokrate ishte në gjendje të udhëhiqte Shqipërinë. (Po aty, f. 471).

18 Krahës kësaj krijimtarije, përgjithësisht optimiste, me frymë popullore, të gjallë e me brendi konkrete, ndonëse edhe me lektisje, në krijimtarinë poetike të L. Poradecit ndeshim edhe një lirikë të mbyllur në vetvete, abstrakte, ku sundon një meditim disa herë artificial. Synimi për të medituuar mbi thellësitë e universit, arsytimet metafizike mbi lëndën e shpirtin, nganjëherë edhe në frymën e kozmogonisë së vedave hindiane, bëjnë që në motivet erotike të kësaj poezie të shfaqen dobësi të botëkuptimit të autorit. Vihet re një orvatje për t’u shkëputur nga bota, nga problemet shoqërore, një si veçim në “kullën e fildishtë”. Dashuria përshkruhet si një “lloftari”, mall që zor se gjen kënaqësi në jetë, dhe që ndjell dëshpërim. (Po aty, f. 528).

19 Po aty, f. 452.

20 Titulli i plotë i poemës është *Poezi shqiptare të shekulli XV. Këngë të Milosaos, bir i sundimtarit të Shkodrës (Poesie albanesi del secolo XV. Canti di Milosao, figlio del despota di Scutari)*, botim dygjuhësh, arbërisht dhe italisht, Napoli, 1836.

arbëresh me letërsinë europiane të kohës. Teksti i 83-it prodhoi klishe në mënyrë rezistente që haset ende edhe sot.

Siç ka përcaktuar Tvetan Todorov më 2017, në thënien maksimë të tij, *një maskë e mbajtur për 40 vjet kthehet në fytyrë*.

Letërsia dhe krijimtaria letrare, si edhe çdo shfaqje artistike e fushave të tjera, karakterizohen nga subjektiviteti; kritika letrare, gjithashtu, është shprehje e gjykimit analitik e vlerësues subjektiv. Kritika letrare udhëhiqet e zbaton parime e metoda në dukje objektive, por imponimi për të vendosur ligjësi e rregull në një objekt si letërsia dhe për ta derdhur atë në kallëpe të ngushtë partishmërie e qëllimore, nga njëra anë dhe diktati për të unifikuar gjykimin kritik në të njëjtin grusht të hekurt të partisë, nga ana tjetër, solli si pasojë, humbjen e subjektivitetit të aktit krijues, humbjen e *letrarësisë*, të thelbit letrar që e bën një vepër të jetë letrare. Ajo solli për rrjedhojë dhe humbjen e “objektivitetit” studimor pasi ishte verifikim i pastër dhe mekanik i zbatimit të metodës. Aplikimi i skemës së socrealizmit e marksizmit nuk synonte të vlerësonte, por të sheshonte veçanti e tipare letrare sipas kallëpit të metodës, në të cilën, një pjesë përputhej, ndërsa pjesa tjetër “ngelte jashtë”, kritikohej e anatemohej.

Në tekstin i ‘83-it synohet historia e letërsisë nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare duke “adaptuar periodizimin e njohur sipas etapave të historisë së popullit tonë”²¹ në tre kapituj kronologjikë: *Letërsi e vjetër shqipe; Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare; Letërsia shqiptare e periudhës 1912-1939*. Dukuritë letrare dhe veprat artistike klasifikohen bazuar në formulime jashtëletrare të huazuara nga fusha e historisë, që nuk shënojnë tipare karakterizuese për grup autorësh, por përpiqen të ndjekin zhvillime letrare sipas ngjarjeve politike në rrjedha kronologjike.

Ja cilat janë fillimet e letërsisë shqiptare të periudhës 1912-1939: “Në këto vite përcaktohen më qartë dy drejtimit e kundërta, që i hasëm në letërsinë e Rilindjes: drejtimi demokratik, i cili shpie më tej trashëgimin e lëvizjes për çlirimin kombëtar dhe u përgjigjet aspiratave të masave për një rend të përparuar politik, ekonomik e shoqëror; drejtimi reaksionar klerikal e borgjez, i cili karakterizohet nga idealizimi i mbeturinave patriarkale-fisnore, rreh të ruajë regjimin antikombëtar e antipopullor të feudoborgjezisë dhe i hap rrugën pushtimit imperialist e fashist.”²²

Historia e letërsisë së ‘83-it, edhe pse u hartua gjatë viteve më të egra të diktaturës, mbeti jetëgjatë në qarkullim. Edhe pas rrëzimit të shtetit totalitar, ai ka shërbyer si tekst bazë në auditorë dhe rrethet shkencore, tekst ku janë mbështetur edhe përgatitjet e teksteve të arsimit parauniversitar dhe një pjesë e konsiderueshme e veprave studimore.

21 Po aty, f. 5.

22 Po aty, f. 453.

Rrugëtimi i historishkrimit të letërsisë sonë vijon në tryeza pune e komisione profesionistësh të cilët ende nuk kanë produkt konkret, edhe pas më shumë se tri dekadash nga rënia e diktaturës dhe motivet me sa duket janë komplekse, por një nga më kryesoret mbetet plotësimi, ndreqja e deformimeve të sistemit të letrave shqipe, përfshirja dhe integrimi i autorëve të censuruar, anatemuar e përndjekur fizikisht, i përfaqësuesve të vleritë të letërsisë shqipe në panteonin letrar në rrafsh sinkronik e diakronik. Ata jetuan një kohë të artë krijimi e vlerësimi, një periudhë të errët 45-vjeçare diktati e denigrimi; e në periudhën e tretë 34-vjeçare ende presin të dalin në dritë.

Letërsi shqipe dhe letërsi e përkthyer

Për letërsitë e krijuara në gjuhë me shtrirje të kufizuar, përkthimi ka qenë dhe mbetet ura themelore e komunikimit me letërsinë botërore, burim i çmuar artistik për lexuesit e pasuri e pazëvendësueshme e kulturës kombëtare, madje, përkthimi ka zënë vend qendror në krahasim me krijimtarinë letrare vendase. Megjithatë, gjatë periudhës diktatoriale, ky funksion estetik dhe kulturor i përkthimit u deformua nëpërmjet filtrit ideologjik të rreptë, që e shndërroi përkthimin nga burim artistik në instrument të indoktrinimit politik. Dogma e partishmërisë letrare impononte që çdo tekst i përkthyer të vinte vetëm nga vendet e kampit socio-komunist, duke përjashtuar kategorikisht letërsinë e quajtur borgjeze, revizioniste e kapitaliste. Procesi i kontrollit mbi përkthimin nuk synonte pasurimin e formimit kulturor të lexuesit, por mbrojtjen e tij nga çdo 'shfaqje reaksionare', duke e reduktuar letërsinë botërore në një repertor të ngushtë dhe të kushtëzuar ideologjikisht, ku estetika dhe pluraliteti kulturor sakrifikohehin në emër të dogmës politike. Studiuesi E. Gjika, teksa merret me përkthimin e letërsisë botërore gjatë periudhës së realizmit socialist, vëren se kriteri politik-ideologjik i përzgjedhjes së përkthimeve në gjuhën shqipe ishte shumë i ngurtë dhe shkonte "plotësisht në varësi të orientimeve dhe aleancave politike të pushtetit komunist në Shqipëri me vendet e tjera ish-komuniste. Bazuar në këto aleanca rrjedhon edhe parapëlqimi në përkthim i kësaj apo asaj letërsie, gjithnjë revolucionare, në binarët e realizmit socialist."²³

23 Eldon Gjika: *Realizmi socialist në sistemin letrar shqiptar (fillimi dhe stabilizimi 1944-1961)*, Tiranë, Albas, 2019, f. 154. Vijnë autori: "...deri në vitin '48 kemi një varg veprash të përkthyer nga letërsia jugosllave. Pas këtij viti, kur marrëdhëniet e Hoxhës dhe Titos marrin fund, letërsia jugosllave nuk do të zërë më vend në tekstet e përkthyer. Nga viti 1945 deri në vitet '60 letërsia sovjetike kishte dominancë absolute në vëllimin e letërsisë së përkthyer në shqip, dominancë e cila nis të zbehet gradualisht, pas prishjes politike të Hoxhës me Hrushovin. Menjëherë pas kësaj nis të shfaqet gjithnjë e më shumë letërsia revolucionare kineze (vietnameze, koreane)... Situata përjashtuese do të riciklohet në vijim. Prishja e marrëdhënieve politike mes Shqipërisë dhe Kinës

Letërsia e huaj, (siç edhe quhej) që vinte në shqip, përzgjidhej dhe servirej si burim formimi i 'njeriut të ri', në zbatim të urdhrit se çdo vepër, që nuk i përshtatej kësaj norme ideologjike, konsiderohej e padenjë për botim.

Në përmbledhjen me dokumente historike për periudhën 1945-1968, *titulluar Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit*²⁴, gjejmë titujt e librave të përkthyer dhe të shtypur nga organet shtetërore deri në vitin 1945, si për shembull:

Fjala e Molotovit mbajtur para mbledhjes solemne të Sovjetit Suprem të Moskës më 6.11.1945; J. Stalin (Biografi e shkurtër), vepër e Institutit Marks-Engels Lenin, Moskë 1945;

Zhvillimi i Kulturës së BRSS – S. Gopner; Lenin (Lenini, i parë prej Stalinit, M. Gorkit; poema e Maiakovskit etj.), edicioni i gjuhëve të huaja; Historia e PKBS; Leninizmi teorik e praktik J. Stalin; Fashizmi dhe klasa punëtore, G. Dimitrov; Klasa punëtore në luftën çlirimtare; Nga letërsia e sotme sovjetike Ehrenburg, Tikhonov etj.; Tregime mbi Leninin nga A. Kononov etj.

Në këtë përmbledhje bën pjesë gjithashtu dokumenti *Njoftim i kryeministrit drejtuar Komitetit Ekzekutiv të Tiranës mbi librat e ndaluar, Tiranë, më 7 gusht 1947*²⁵ – në të cilin jepen *hapat e veprimit për spastrimin e librave të dëmshme simbas listave të dërguara*- që i hapin rrugë zbatimit të vendimeve të konferencës III që do të mbahet pas një viti.

Ndër autorët e letërsisë botërore më të botuar nga Tirana zyrtare, që njëherësh janë më të përcjellë te lexuesi ynë, shënojmë: *Nëna* e M. Gorkit; *Garda e re* e A. Fadajev, *Tokat e çara Doni i qetë* të M. Shollohovit; *Si u kalit çeliku* e N. Ostrovski; romane dhe reportazhe të luftës nga Ilja Ehrenburg etj., por edhe vepra të letërsisë klasike, si: *Shpirtra të vdekur* e N. Gogolit; *Armiku i popullit* i H. Ibsenit; *Njeriu që qesh*, *Viti '93* të V. Hygoit; *Lufta dhe Paqja*, *Ana Karenina* të L. Tolstoit; *Komedia njerëzore* e H. Balzakut, si dhe nga romanizmi *Shtegtimet e Çajld Haroldit* nga G. Bajroni etj.

Konferenca e III-të e Lidhjes së shkrimtarëve të Shqipërisë, më 1949, i kushtoi mjaft vëmendje edhe përkthimit. Në fjalën e tij *Mbi përkthimet letrare*, Sotir Caci shprehte këmbënguljen se ashtu si në çdo fushë edhe në letërsi dhe përkthim "ne pështetemi në radhë të parë dhe kryesisht në eksperiencën e pasur sovjetike. Literatura sovjetike, pararojë e literaturës përparimtare në botë, nuk duhet të njihet e të studiohet vetëm

në fundin e viteve '70, do të pasohet me reduktim të ndjeshëm, deri në mungesë, të përkthimeve nga letërsia kineze."

24 B. Meta, A. Krasniqi, H. Bello, *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit* (Dokumente historike), vëllimi I (1945-1968), Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2018, f. 32-35. <https://works.hcommons.org/records/w16m9-hzd69>

25 Po aty, f. 67.

nga shkrimtarët e letrarët tanë, po edhe nga masat e gjera punonjëse të popullit... ne na duhet të zgjedhim përkthimet më të domosdoshme që janë si të thuash në rendin e ditës për ne, që na shërbejnë drejt për së drejti në etapën tonë aktuale, në rrugën drejt socializmit.”²⁶ Një dokument tjetër shumë i rëndësishëm gjendet në vëllimin e dytë të përmbledhjes me dokumente *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit, 1969-1973*, me titull *Studim i komisionit të kulturës në Komitetin Qendror të PPSH, mbi gjendjen dhe kriteret themelore për botimet në fushën e letërsisë origjinale dhe të huaj*. Në këtë material të vitit 1969 raportohet hollësisht mbi botimet e letërsisë së sotme të realizmit socialist, mbi botimet e trashëgimisë sonë letrare; botimet e letërsisë për fëmijë e të rinj; gjendjen e botimeve nga letërsia e huaj dhe mbi rrugën që duhet të ndiqet në të ardhmen; përkthimet për fëmijë e të rinj dhe në fund parashtrohen kriteret e botimeve në të ardhmen dhe disa masa që duhen ndërmarrë për t’i dhënë popullit në duar libra, *jo për t’i çoroditur shpirtërisht, por për t’i armatosur me ideologjinë komuniste*. Duke theksuar se partishmëria në të gjitha fushat e ideologjisë dhe të kulturës sonë pa dyshim është pasqyruar edhe në politikën e botimeve nga letërsia e huaj, dokumenti në fjalë parashtron në mënyrë të detyrueshme se “Në përkthimet tona duhet të drejtohem në radhë të parë, nga letërsia revolucionare dhe letërsia me një tendencë të qartë demokratike e përparimtare e të gjitha kohërave. Ne duhet të kemi gjithmonë parasysh mësimet e shokut Enver që letërsia botërore duhet të zgjidhet sipas vlerës njohëse që të na njohë me luftërat e popujve, me luftën e klasave, me indoktrinimin komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit gjendjen reale të shoqërisë në të kaluarën dhe sipas vlerës ideologjike, sa na shërben ajo në edukimin e njeriut tonë në formimin ideor, kulturor dhe artistik të tij.”²⁷ Kontrolli politik dhe censurimi i veprave i besohej më së shumti redaktorëve për të cilët “Shkurtimi i veprave në përgjithësi me vlerë, po me të meta të rëndësishme ideologjike, me skena pornografike, ose me shprehje të hapura të qëndrimeve filozofike të dëmshme, etj., është gjë e domosdoshme.”²⁸

26 *Konferenca e III-të e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, (9-12 tetor 1949)*, Tiranë, 1950, f. 55, 56.

27 B. Meta, A. Krasniqi, H. Bello: *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit, 1969-1973*, (Dokumente historike), vëllimi II (1969-1973), Tiranë, 2019, f. 170-171. <https://works.hcommons.org/records/b5ypm-6d841>

Kritika e shokut Enver në fjalimin e 7 Marsit, për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, i thelloi akoma më tej kriteret e vlerësimit e të përkthimit të kësaj letërsie. Mjafton të përmendim se për më se dhjetë vjet botimet e letërsisë artistike të huaj kanë zënë me të padrejtë më shumë se 50% të gjithë botimeve tona (sot kjo shifër ka zbritur në 12%). (f. 166).

28 Po aty, f. 172-173. “Mund të botohet Balzaku me “Iluzionet e humbura” ose “Fshatarët”, mund të botohen me reduktime ose me parathënie e studime të thelluara vepra si

Po përvijojmë shkurtimisht tri rrafshe kryesore të (mos)trajtimit të letërsisë botërore nga shteti diktatorial, gjatë periudhës 1945-'90:

- Heshtja e plotë për poetë e shkrimtarë, mendimtarë e filozofë të kulturave europiane e botërore, të cilët censuroheshin plotësisht: kujtojmë këtu etjen në fillim të viteve '90 për të lexuar fondin më të madh të letërsisë dhe të mendimit botëror që shënjonte vlera mirëfilli estetike: Sartrin, Kamynë, Kafkën Prustin, Frojdn e shumë të tjerë dhe magjinë e tyre në formimin e përpunimin e shijes artistike të lexuesit në përgjithësi dhe të lexuesit të kualifikuar, studiuesve, pedagogëve, kritikëve të artit, më në veçanti. Mjafton ky fakt për të theksuar shtypjen e madhe që kishte ushtruar tek ne letërsia e shabllonizuar, prej së cilës, duket se një pjesë lexuesish ende s'kanë mundur të shkëputen përfundimisht.

Sjellim në vëmendje këtu leximet e të rinjve sot, një pjesë e të cilëve, sipas anketimeve, parapëlqejnë të lexojnë vepra letrare të socrealizmit që janë zhvilluar në shkollë gjatë periudhës totalitare. Formimi i këtyre lexuesve është i lidhur ngushtë me horizontin e pritjes të krijuar gjatë viteve shkollore, ku themelet e dijes u janë transmetuar përmes një didaktike të trashëguar nga mësues të formuar para viteve '90. Pa mundësinë e përditësimit të leximeve dhe interpretimit kritik, ky transmetim didaktik ka riprodhuar modele të leximit të socrealizmit, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si brezi i ri e percepton letërsinë.

Studiuesit (H. Bloom, G. Steiner, T. Eagleton, U. Motta, J. Aston etj.) i kushtojnë rëndësi vendimtare shkollës në përçimin e dijeve kanonike, në ruajtjen dhe rikonfigurimin e tyre, në krijimin e kompetencave kritike të nxënësve, si dhe në formimin kulturor e identitar të tyre. Harold Bloom në veprën e njohur *The Western Canon: The Books and School of the Ages* (*Kanoni Perëndimor: Librat dhe Shkolla e Epokave*) e lidh drejtpërdrejt kanonin letrar me shkollën, sepse në shkollë kanoni merr formë konkrete përmes leximit, mësimit dhe interpretimit të autorëve klasikë, duke ruajtur kujtesën kulturore dhe duke e rikonfiguruar brez pas brezi. Për Bloom-in, kanoni nuk pasqyron një listë e ngurtë, të përcaktuar nga kritikët, por një traditë të gjallë që formohet në institucionet mësimore dhe që mbijeton falë fuqisë estetike të veprave. Ai thekson se "Kanoni është me të vërtetë shkolla e vërtetë e epokave, sepse përmban ata shkrimtarë që janë lexuar dhe do të vazhdojnë të lexohen e rilexohen, të mësohen e rimesohen, të interpretohen e rinterpretohen."²⁹

"Viti 93" dhe "Njeriu që qesh" i Hygoit, ku të analizohen anët pozitive dhe negative të tyre. Por mendojmë se një vepër si "Të mjerët" me gjithë anët pozitive, pasqyrimin e disa aspekteve të revolucionit, krijimin e disa tipave nga njerëzit e thjeshtë në tërësi, nuk do të na ndihmonte në edukimin e brezit të ri, sepse autori është nisur nga pozita e mëshirës kristiane, nuk ka kudo një analizë realiste dhe zbërthim të thellë të kontradiktave shoqërore (Edhe filmi që shfaqet është me këto të meta." (f. 171).

29 Harold Bloom, *The Western Canon: The Books and School of the Ages*, New York Harcourt

Në këtë këndvështrim, sot një pjesë e problemeve është e vështirë të korrigjohet në universitet, pasi studentët e vitit të parë vijnë nga arsimi i detyruar dhe i mesëm me një ngrehinë njohurish. Mungesat dhe deformimet e kësaj ngrehine në aspekt të analizës dhe interpretimit letrar nuk i mundësojnë lehtësisht ndërhyrjet ripërmasuese e rivlerësuese. Është edhe më e vështirë, pothuaj e pamundur, ndërhyrja te pjesa më e madhe e të rinjve lexues, të cilët me mbarimin e shkollës së mesme ndërpresin marrëdhëniet e edukimit letrar përmes institucionit.

- Censurimi i pjesshëm i krijimtarisë së autorëve të letërsisë botërore, sidomos ligjërimi politik apo tonet antiautoritare, pjesët religjioze apo reflektimet teologjike dhe ligjërimi i jetës intime erotike, që realizohej kryesisht nga redaktorët e shtëpive botuese në përputhje të plotë me vijën ideologjike të kohës.

Po sjellim këtu shembullin e romanit *Me syrin e një klouni* të H. Böll, përkthyer nga A. Klosi, që u botua për herë të parë më 1984, i cili përbën rast tipik për mënyrën se si lexuesi shqiptar komunikonte me kryeveprat e letërsisë botërore. Vepra u censurua duke fshirë pjesë e fraza të lidhura me ideologjinë antikomuniste, jetën intime, besimin fetar, që regjimi i kohës nuk mund t'i lejonte. Në vitin 2006 vepra u botua e pacensuruar dhe sërish nën shqipërimin e A. Klosit. Në këtë botim pjesët e censuruara të botimit të parë janë hijezuar, duke i ofruar lexuesit një receptim krahasues midis tekstit autentik (2006) dhe atij të gjymtuar (1984).

“Isha njëzet e një vjeç, ajo nëntëmbëdhjetë, kur vajta një natë drejt e në dhomën e saj për të bërë me të gjërat që bëjnë mashkulli me femrën. E pata parë mbasdite me Xypfnerin, tek dilyn të dy nga Pallati i Rinisë; qenë kapur për dore, buzëqeshnin dhe mua diçka më sëmboi. Nuk qe e dashura e Xypfnerit dhe kjo kapje marroqe për dore më bënte ligisht.”³⁰

Po kështu, romani *Robinson Kruzo* i D. Defosë; *Lufta dhe Paqja, Ana Karenina* të L. Tolstoj; romani *Të Mjerët* i V. Hygosë; veprat e F. Dostojevskit, *Vëllezërit Karamazov* dhe *Djajtë* etj., u botuan në shqip, por kapitujt me përmbajtje fetare, mistike ose kritika ndaj pushtetit u hoqën ose u shkurtuan. Vepra shkonte tek receptuesi e censuruar, gjë që zhvishte romanin nga një shtresë e rëndësishme filozofike dhe artistike, si dhe deformonte vlerën estetike të tij. Lista është e gjatë dhe meriton një qasje të mëtejshme studimore, por ajo që vlen të theksojmë është dukuria

Brace, 1994, f. 16. (The Canon is indeed the true School of the Ages, because it contains those writers who have been, and who will continue to be, read and reread, taught and retaught, interpreted and reinterpreted).

30 Heinrich Böll, *Me syrin e një klouni*, përktheu A. Klosi, Tiranë, Dudaj, 2006, f. 7. Në këtë botim, pjesa e hijezuar e fjalisë: *për të bërë me të gjërat që bëjnë mashkulli me femrën*, shënon pjesën e hequr të tekstit në botimin e 1984-ës.

e dhunimit të origjinalitetit të autorit, e cungimit të tekstit, rrafshimit të polifonisë ligjërimore, duke i ofruar lexuesit shqiptar një tekst të zbehtë dhe të varfër artistik, por në hullinë e duhur ideologjike.

- Keqinterpretimi i teksteve letrare, si nga letërsia botërore ashtu edhe nga ajo kombëtare, u realizua sipas të njëjtit model të kritikës ideologjike të aplikuar mbi autorët shqiptarë. Ky model synonte që çdo vepër të përshtatej pikë për pikë me parimet e partishmërisë, figurën e heroit pozitiv, idenë kryesore dhe qëllimshmërinë ideologjike. Prandaj, poetët romantikë të natës magjike me hënë, të vetmisë së poetit, apo autorët që trajtonin tëhuajsimin dhe krizën identitare të individit të shekullit XX, u interpretuan në mënyrë të deformuar për t'u përputhur me doktrinën e realizmit socialist.

Çdo botim, veçanërisht ato që ngjallnin dilema mbi praktikën krijuese të socrealizmit, shoqërohej me parathënie ideologjike³¹, e cila përcaktonte qartë hullinë nga duhej lexuar e analizuar vepra artistike dhe orientonte studiuesit drejt interpretimit marksist. *Komedia njerëzore* e Balzakut u botua me kapituj të përzgjedhur, duke u trajtuar si dëshmi e dekadencës borgjeze, ndërkohë që ndalohej të lexohej si një panoramë e thjeshtë e jetës moderne në kapitalizëm. Botimi i romanit *Të mjerët*, i V. Hugosë u shoqërua me parathënien e detyrueshme, që e zhveshi veprën nga thelbi i saj kristian, misticizmi dhe thirrjet për mëshirë universale. Regjimi i etiketonte këto veçori si *humanizëm borgjez* apo *moralizëm kristian i vjetëruar*, duke argumentuar se Hygoi gabonte që kërkonte shpëtimin përmes moralit dhe jo përmes përmbyesjes me dhunë të sistemit. Në vend të këtyre, romani u shqyrtua si një “dëshmi e gjallë e shtypjes kapitaliste dhe e luftës së klasave”,³² ku barrikadat e Parisit trajtoheshin si paralajmërim i revolucionit proletar. *Ana Karenina* e Lev Tolstoi u paraqit si kritikë ndaj

31 Vlen të shënojmë se sidomos në vitet '50-'60 të shekullit të kaluar, periudha kur po rrënjosej realizmi socialist në Shqipëri, shpesh, parathëniet e veprave të përkthyer nuk nënshkruheshin nga një emër i vetëm studiuesi apo përkthyesi, por nga redaksia e shtëpisë botuese shtetërore. Kështu ndodhi me botimin e parë të romaneve dhe kapitujve të përzgjedhur nga *Komedia njerëzore* e Balzakut, në parathënie të së cilës vepra interpretohej rreptësisht si një autopsy dhe dëshmi e gjallë e kalbëzimit, dekadencës dhe pamoralshmërisë së borgjezisë franceze të shekullit XIX. Edhe parathënia e romanit *Ana Karenina* e L. Tolstait, përkthyer nga Vedat Kokona, botuar në vitin 1961, nuk mban emrin e një autori apo studiuesi të vetëm shqiptar, por u botua në emër të redaksisë së shtëpisë botuese Naim Frashëri. Në parathënie ajo paraqitej si një pasqyrë që demaskonte hipokrizinë e borgjezisë dhe aristokracisë, duke e zhvendosur vëmendjen nga dilemat e thella morale.

32 Viktor Hygo: *Të mjerët*, përktheu Misto Treska, /parathënia Shefik Osmani/, Tiranë, Naim Frashëri, 1954, f. 12. Pjesë të caktuara të romanit, si jeta e Gavroshit dhe Kozetës u shkëputën dhe u botuan si libra më vete edukativë për fëmijët në shkollë për të ilustruar mjerimin e thellë të fëmijëve në vendet kapitaliste.

aristokracisë dhe borgjezisë, duke lënë në hije dilemat shpirtërore dhe rrafshin moral të romanit. *Don Kishoti* i M. Servantesit u paraqit si satirë ndaj rendit feudal dhe si shembull i luftës së masave kundër padrejtësisë shoqërore, duke deformuar ironinë dhe kompleksitetin estetik të veprës, duke injoruar plotësisht lojën gjeniale estetike, ambivalencën dhe natyrën parodizuese që Servantesi i bëri letërsisë kalorësiake. Reduktimi i shtresëzimeve të shumta të këtij romani themeltar të letërsisë moderne, bëri që kjo vepër me kompleksitet të lartë filozofik të shndërrohej në një manifest të thjeshtë politik.

Vërehen ende sot, pas 35 vitesh paszgjatime të së njëjtës linjë demarkacioni hartuar gjatë konferencës së 1949-ës e, le t'i kthehemi këtu kreut të këtij punimi, zinxhirit edukativ të të rinjve. Tashmë dëmtimet e tablosë na shfaqen në arsimin parauniversitar, në problemet e formimit universitar të mësuesve të diplomuar para viteve '90, një pjesë e të cilëve nuk kanë dalë përtej këtij konteksti dhe vijnë të besojnë se *Lahuta e malcis'* duhet kthyer në shqipen standarde. Po kështu vjen kërkesa absurde që poetët arbëreshë De Rada, Z. Skiroi, Gavril Dara i riu, Z. Serembe të kthehen në shqipen standarde.³³ Burimi i këtyre kërkesave gjendet në imponimin për të zbatuar edhe në krijimtarinë letrare gjuhën standarde të vendosur në Kongresin e drejtshkrimit (1972), që solli edhe imponimin e një leximi të unifikuar në funksion të projektit gjuhësor e ideologjik të kohës. Janë pasoja të realitetit të egër të paraviteve '90, që deformoi rrafshin estetik të veprave, por edhe i largoi ato nga konteksti i tyre historik e kulturor, duke i paraqitur si tekste të përshtatura sipas gjuhës standarde dhe jo si dëshmi të gjalla të letërsisë, që u krijua në mërgatë apo në gjuhë dialektore e nëndialektore.

Përsëri ndeshim mësues që e shpjegojnë kryeveprën e poetit arbëresh dhe themeltaren e letërsisë sonë moderne përmes këndit të errët socrealist, ndërkohë që ligjërimin zotërues të shek. XIX për dashurinë nuk e shohin në përkushtimin, vuajtjen e ëmbël e përkuljen e Milosaos para "fustanit me lulka" të Rinës, por vetëm e vetëm në angazhimin patriotik. Janë të dukshme pasojat e dy burimeve kryesore që kanë ushqyer një trajtim të tillë, *Historia e Letërsisë Shqiptare* (1983) dhe botimi i poemës *Këngë të Milosaos* (1987), përshtatur në shqipen e sotme dhe e shoqëruar me parathënie nga Dh. Shuteriqi.³⁴

33 Konstatimet e lartshënuara bazohen në përvojën shumëvjeçare si pedagoge e lëndëve *Letërsi shqipe e vjetër* dhe *Letërsi shqipe e Rilindjes* për studentët e vitit të parë të ciklit bachelor, të cilët sapo janë shkëputur nga shkolla e mesme dhe reflektojnë problematika të të nxëniet që lidhen me mësuesit. Përvoja si bashkautore e teksteve shkollore për sistemin parauniversitar, përvoja e trajnimeve të mësuesve, si dhe nga anketimet e kryera nga studentët që kam drejtuar në hartimin e tezave të diplomave të ciklit master i përforcojnë këto gjetje.

34 Jeronim De Rada: *Këngët e Milosaos*, pajisur me shënime dhe përshtatur në gjuhën e

Nuk njihet figura e Z. Skiroit dhe veprën e tij, në rastin më të mirë, e shohin në klishenë e *poetit reaksionar, filoitalian e fashist* që i këndoi Italisë, ashtu siç është trajtuar para viteve '90 të shekullit të kaluar, duke lënë mënjanë një nga veprat më të bukura të romantizmit shqiptar, poemën *Mili dhe Hajdhia* apo një majë të lartë artistike të ligjërimit elegjiak, siç është poema *Mino*.

Për fat të keq, Asdreni vijon të këndvështrohet vetëm në motivin atdhetar e si rilindës romantik, duke lënë në hije poezinë e tij meditative, filozofike të përsiatjeve të vetmitarit, sidomos për dy vëllimet e fundit *Psallme murgu* dhe *Këmbanat e Krujës*. Ndërkohë, vetmia dhe dëshpërimi i unit lirik shënon nivelin më të lartë artistik, që e zgjeron poetikën e tij drejt letërsisë rumune me M. Emineskun, T. Arghezin, A. Macedonski etj. dhe, më tej, asaj europiane. Shenjat e qarta të simbolizmit dhe parnasizmit, përmes figurave akustike, korrespondencave shqisore dhe introspeksionit metafizik të krijimtarisë poetike të fazës së dytë, e lidhin Asdrenin me poetë të shquar të letërsisë franceze.

Ka mësues që Migjenin vijnë ta trajtojnë në kallëpin socrealist, duke ia reduktuar krijimtarinë në shprehje të revoltës sociale, ndërsa dimensionin ekzistencial dhe metafizik i poezisë së tij anashkalohet. Ndërkohë, autorë si M. Camaj e Gj. Fishta - të cilët duhen parë, para së gjithash, si pasuri të ligjërimit shqip - shpesh etiketohen si "poetë të vështirë", për shkak se shkruajnë në gegnisht. Ky perceptim i përmbysur i ka shndërruar në autorë të paragjykuar, duke u atribuar atyre komplikime të mbartura nga e kaluara në procesin e të mësuarit dhe të të nxënit, në vend që të vlerësohen për pasurinë gjuhësore dhe estetike që sjellin në traditën letrare shqiptare.

Fakti që *Lahuta e Malcis'* e Fishtës nuk është përfshirë asnjëherë në provimin e Maturës shtetërore flet shumë, jo vetëm për mangësi njohurish të domosdoshme nga ana e mësuesve, por, ç'është më e keqja, për një refuzim institucional që reflektohet drejtpërdrejt tek nxënësit.

Probleme vërehen edhe në mësimdhënien e lëndëve *Gjuha shqipe* dhe *Letërsia* nga të diplomuar pas viteve '90, po dhe për mësues që janë diplomuar gjatë viteve të fundit, një pjesë e të cilëve nuk mundën ta ndryshojnë perceptimin që morën për letërsinë në vitet e shkollimit të detyruar e atij të mesëm.

Në këtë këndvështrim, jo vetëm nuk mbetet jashtë problematikës universiteti, po është një nga hallkat kryesore të këtij sistemi jo pak të ndërlikuar. Mbështesim idenë se arsimi parauniversitar, veçanërisht ai i detyruar është vatra themelore e fitimit të njohurive dhe shijeve artistike, siç është theksuar nga At' Zef Pllumi deri te figura të shquara të mendimit njerëzor dhe të kulturës; është një nga vatrat më afatgjata ku është zbatuar shpërbërja e vlerave estetike letrare gjatë periudhës totalitare.

sotme nga Dhimitër S. Shuteriqi, Tiranë, Naim Frashëri, 1987.

Diskutime do të ngriheshin, me këtë rast, mbi metodat e mësimdhënies në të cilat zotërojnë ende *ideja* dhe *personazhi kryesor* apo koncepte të tjera të tejkaluara, në vend të trajtimit ligjërimit artistik të veprave dhe *dominanteve letrare* (R. Jakobson). Është esencial evidentimi i vlerave të njëmendta që gjenden që në krijimtarinë poetike të themeluesit të letërsisë sonë moderne, Jeronim de Rada dhe vijimësisë tek autorë të tjerë të historisë së letërsisë shqiptare.

Do të theksojmë pra, dhe një herë rolin vendimtar që i kushtojnë studiuesit shkollës në transmetimin e dijeve për letërsinë kombëtare. U. Eko teksa fliste për të nxitur sjelljet e të lexuarit tek fëmijët iu drejtua mësuesve: *mësues kur u flisni nxënësve për letërsinë dhe të lexuarit, pyesni edhe veten a e keni lexuar këtë libër?*

Duke mbështetur idenë e rolit kyç që luan shkolla në përvetësimin e njohurive kanonike prej nxënësve, theksojmë çlirimin që duhet të kenë të gjitha hallkat e zinxhirit edukativ nga gjurmët e periudhës 1944-1990, çlirimin mendor të mësuesve, studiuesve të letërsisë, të hartuesve të strategjive edukative e kulturore dhe të teksteve, për të ndrequr të gjitha deformimet e trajtimit të autorëve, të analizimit dhe interpretimit të tyre që drejtpërdrejt reflektohen në shpalosjen tërësore të vlerës estetike.

Në përfundim, analiza e shformimeve të vlerës estetike letrare gjatë periudhës së diktaturës dëshmon se letërsia shqiptare u vendos nën një regjim të fortë ideologjik, ku kanoni u gjymtua, autorët u censuruan ose u anatemuan, ndërsa kritika letrare humbi funksionin e saj estetik për t'u shndërruar në instrument propagandistik. Historia e letërsisë, tekstet universitare dhe përkthimet nga letërsia botërore u përdorën si mjete të indoktrinimit, duke prodhuar një kulturë të deformuar, gjurmët e të cilës shfaqen përsëri sot në sistemin arsimor dhe në shijen letrare të lexuesve. Ky trashëgim i deformuar ka ndikuar në mënyrën se si letërsia perceptohet jo vetëm nga brezat e formuar gjatë diktaturës, por edhe nga ata pas saj. Prandaj, detyra e sotme e studiuesve dhe institucioneve arsimore është të ndërmarrin një proces të plotë rishikimi, integrimi dhe rivlerësimi, duke korrigjuar keqinterpretimet dhe duke e rikthyer dimensionin estetik të letërsisë shqipe si pjesë të rrjedhave të letërsisë europiane. Është mënyra e vetme prej nga mund të çlirohet historia e letrave nga ngurtësia ideologjike dhe të ofrohet një tablo e plotë dhe emancipuese për brezat e ardhshëm.

BIBLIOGRAFI:

- Ali Xhiku: *Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945-1961*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2022.

- At Justin Rrota: *Letratyra Shqype per shkolla të mjesme*, Shkodër, Shtypshkoja Françiskane, 1925.
- B. Meta, A. Krasniqi, H. Bello: *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit* (Dokumente historike), vëllimi I (1945-1968), Akademia e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2018. <https://works.hcommons.org/records/w16m9-hzd69>
- B. Meta, A. Krasniqi, H. Bello: *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit*, (Dokumente historike), vëllimi II (1969-1973), Tiranë, 2019. <https://works.hcommons.org/records/b5ypm-6d841>
- Eldon Gjika: *Realizmi socialist në sistemin letrar shqiptar (fillimi dhe stabilizimi 1944-1961)*, Tiranë, Albas, 2019.
- E. Koliqi, N. Resuli, K. Gurakuqi: *Shkrimtarë Shqiptarë, Histori e Letërsisë Shqipe*, Tiranë, 2007. *Historia e Letërsisë Shqipe I, II*, Tiranë, 1959, 1960.
- Harold Bloom: *The Western Canon: The Books and School of the Ages*, New York Harcourt Brace, 1994.
- Heinrich Böll: *Me syrin e një klouni*, përktheu A. Klosi, Tiranë, Dudaj, 2006.
- *Historia e Letërsisë Shqiptare*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1983,
- *Historia e letërsisë shqiptare e realizmit socialist*, (maket) botuar në Tiranë, 1978.
- Jeronim De Rada: *Këngët e Milosaos*, /pajisur me shënime dhe përshtatur në gjuhën e sotme nga Dhimitër S. Shuteriqi/, Tiranë, Naim Frashëri, 1987.
- *Konferenca e III-të e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, (9-12 tetor 1949)*, Tiranë, 1950.
- Literatura Jonë, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Tiranë, 1947.
- Literatura Jonë, Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Tiranë, 1948.
- Romano Luperini: *Insegnare la letteratura oggi*, San Cesario di Lecce, Manni, 2020.
- Lev Tolstoi: *Ana Karenina*, përktheu Vedat Kokona, Tiranë, Naim Frashëri, 1961.
- Viktor Hygo: *Të mjerët*, përktheu Misto Treska, Tiranë, Naim Frashëri, 1954.